



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Thirrje publike për mbështetje financiare të OJQ-ve jo-qeveritare të komuniteteve

Gjakovë, 15.09.2023

1. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthime (ZKKK) u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare që vijnë nga radhët e komuniteteve jo shumicë (Rome, Ashkali dhe Egjiptian) të Regjistruar në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e komuniteteve pakice, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në Strategjinë për Avancimin e të drejtave të komuniteteve rome dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin Punese të zyrës Komunale për Komunitete dhe kthimi 2023, po ashtu kontribuojnë në zhvillimin dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.

2. OJQ-të e komuniteteve në përputhje me këtë thirrje mund të aplikojnë me projekte për fushatat e tyre prioritare si në vijim:

1. Projektet që promovojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, dhe ju mundësojnë qasje të barabartë në të gjitha ofrimin e shërbimeve publike
2. Organizimi i trajnimeve për të rinjtë e komuniteteve bazuar në kërkesat e tyre dhe tregun e punese në komunën Gjakovës.

3. Organizata jo qeveritare të udhëhequra nga komunitetet pakice në komunën e Gjakovës mund të aplikojnë me Projekte që kontribuojnë zbatimin e aktiviteteve në fushën e komuniteteve përmes aktiviteteve :

- ✓ Aktivitetet që kanë për qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve,
- ✓ Aktiviteti që kanë për qëllim promovimin e kulturës së komuniteteve dhe debatet që i kontribuojnë shoqërisë në përgjithësi e në veçanti dialogut ndëretnik dhe antidiskriminimit,
- ✓ Aktivitete që i kontribuojnë ngritjen e kapaciteteve, aftësimin dhe punësimin tek të rinjtë e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian duke i dhënë përparësi aktiviteteve inovative.

4. Për OJQ-të që aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktivisteve shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të aplikojnë për një projekt është 300.00 € ndërsa shuma maksimale për një projekt është deri në 2000.00 €

5. Aplikantët dhe partneret potencial për pjesën tjetër të kostove mund të sigurojnë bashkëfinancim nga donatorët dhe burimet tjera publike apo vetanake.

6. Afati për dorëzimin e propozimeve është jo më pake se 15 ditë punë. Duke filluar nga data **15.09.2023** dhe përfundon me datën **05.10.2023**.

7. OJQ-të mund të aplikojnë më së shumti me dy(2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. E njëjta OJQ mund të jetë në partneritet në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

8.Periudha e zbatimit të projekteve është brenda vitit 2023

9.OJQ-të po ashtu duhet të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyre transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitete si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.

10.Të drejtë aplikimi për projektet e tyre kanë OJQ-të që janë regjistruar në regjistrat e organizatave jo qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vite para datës së publikimit të thirrjes publike, (të prezantohet certifikata e numrit fiskal, certifikata e regjistrimit dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar).

11.Së bashku me aplikacionin ,OJQ të janë të obliguara të paraqesin dëshmi e Vërtetimit Tatimor të ATK-së dhe Vërtetimin e Gjykatës Ekonomike të OJQ-së.

12.Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e parapare, të cilët së bashku me Udhëzimet për Aplikantët janë në dispozicion në faqen e internetit Komuna Gjakovës/Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (kk.rks-gov.net/gjakove/).

13.Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht në adresën :Rr. UÇK-së p.n.50.000 Gjakovë, Republika Kosovës/Zyra | Komunale për Komunitete dhe Kthim.

14.Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimi të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalanderin tregues të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

15.Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të parapare me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

16.OJQ-të të cilat kanë qenë përfituese të subvencioneve gjatë vitit 2023 nuk mund të aplikojnë në këtë thirrje.

17.Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike të sqarohet në zyrat e ZKKK-së.